

Kryetari i komunës së Preshevës



Shqiprim Arifi është nga fshati Tërnavë i komunës së Preshevës, ka lindur më 14.06.1976, në Mannheim të Gjermanisë.

Prej vitit 1987 deri më 1995, Arifi në Gjermani ka vijuar Shkollën Fillore „Karl-Boch“, ku dhe ka arritur nivelin „Sekundar stufe II“ dhe në drejtimin e logjistikës ka kryer Shkollën Ekonomike „Wirtschaft I“, të cilën me sukses e ka kryer në vitin 1998. Pas kësaj ka filluar të punoj në kompaninë „HAFF“ si udhëheqës i sektorit ndërkombëtar.

Nga viti 2002, ka hapur biznesin individual e tij në fushën e logjistikës. Shumë shpejtë ka arritur që të hap edhe degën e kompanisë së vet në Shtuttgart, Lepizing, Hamburg, Bratisllavë dhe Kumanovë.

Nga Gjermania është kthyer në vitin 2003, për të jetuar dhe kontribuar zhvillimit të komunës së Preshevës.

Në vitin 2016, është zgjedhur kryetar i komunës së Preshevës. Për kryetar të Organit të Përkohshëm të komunës së Preshevës është emëruar në muajin shtator të vitit 2017, në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi formimin e Organit të Përkohshëm në këtë vetqeverisje lokale.

Në shkurt të vitit 2018, Shqiprim Arifi për herë të dytë është zgjedhur kryetar i komunës së Preshevës.

Shqiprim Arifi është i martuar dhe ka tri vajza.